



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL NË MALISHEVË



Nr. 02/199

Datë; 06/09/2011

Mbështetur në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale – Ligji nr.03/L-040, neni 12 par.2 pika “d”, neni 14, neni 35, neni 58 pika “h” si dhe në nenin 30.5 të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 datë, 12.11.2008, rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, nr.02/182 më datë, 17.08.2011,

Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur më datë, 29.08.2011 mori këtë

V E N D I M

**PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR PARKUN E GJELBËRT NË MIRUSHË KK-
MALISHEVË**

Neni 1

Miratohet, Propozimi i Kryetarit të Komunës nr.01/1337 i datës, 17.08.2011, për ndërtimin e parkut të gjelbërt në fshatin Mirushë KK- Malishevës.

Neni 2

Lokacioni sipas nenit 1 të këtij vendimi është sipërfaqja prej, 4.00.00 ha ne z.k në Mirushë që shtrihet në ngastrën kadastrale nr.1021 nr. i certifikatës P-72310050-01021-2 dhe ngastra nr.1025 nr. i certifikatës P-72310050-01025-1 të dyja pronë shoqërore në emër të KK. Malishevë, ridestinohen për ndërtimin e parkut të gjelbërt të quajtur “ Parku i Gjelbërt në Fushën e Begut” me qendër në fshatin Mirushë të Malishevës.

Neni 3

Kjo sipërfaqe ndahet nga zona kadastrale e shpallur Zonë industriale , sipas Vendimit nr.01/328 datë, 10.06.2004, dhe kjo sipërfaqe regjistrohet me numër të ri .

Neni 4

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Shërbim Pronësoro - Juridik ,dhe drejtoria për Urbanizëm brenda afatit të paraparë ligjor, duhet t'i kryej procedurat e implementimit të këtij Vendimi të vendosur nga KK. i Malishevës. .

Neni 5

Për zbatimin e këtij përkujdeset, Kryetari i Komunës së Malishevës.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë nga dita e miratimit e të njëjtit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës.

Vendimi u dërgohet:

Arkivit

Drejtorisë për Gjeodezi

MAPL

